VENDIM
Nr. 1033, datë 27.11.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NR. TF014761 NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) E SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), QË VEPROJNË SI ADMINISTRATORE TË FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA DISA DONATORË, PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË BAZUAR NË REZULTATE PËR MIRËMBAJTJEN DHE SIGURINË RRUGORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF014761 ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) e Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), që veprojnë si administratore të fondeve grant të siguruara nga disa donatorë, për përgatitjen e projektit të bazuar në rezultate për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore, nëpërmjet një granti prej 700 000 (shtatëqind mijë) USD, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE
PËR ZHVILLIM

1818 H Street N.W.
Washington, D.C. 20433
USA

(202) 477-1234
Adresa kabllore: INTBAFRAD
Adresa kabllore: INDEVAS

23 tetor 2013

SH.T. Ridvan Bode
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Lënda: Granti për Shqipërinë nr. TF014761 për përgatitjen e projektit të sigurisë dhe mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në rezultate

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (Përfituesi), kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore) që vepron si administrator i fondeve të grantit të dhënë nga donatorë të ndryshëm (donatori(ët)) sipas Fondit të Besimit Programatik me shumë donatorë për zhvillimin e kapaciteteve në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, propozon dhënien Përfituesit të një granti në një shumë që nuk kalon shtatëqind mijë dollarë amerikanë (US$ 700,000) (granti), sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë letërmarrëveshje (marrëveshja), që përfshin aneksin bashkëlidhur për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në aneks (granti).

Ky grant financohet nga fondi i besimit të sipërpërmendur, për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatorët. Në pajtim me seksionin 3.02 të kushteve standarde (sipas përkufizimit në aneksin e kësaj marrëveshjeje), detyrimet për pagesë të Bankës Botërore në lidhje me këtë marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve të vëna në dispozicion për të nga donatorët, sipas fondit të besimit të sipërpërmendur dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr shumat e grantit i nënshtrohet disponibilitetit të këtyre fondeve.

Përfituesi përfaqëson, duke konfirmuar pëlqimin e tij më poshtë, se është i autorizuar të lidhë këtë marrëveshje dhe të zbatojë grantin në pajtim me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të përmendura në këtë marrëveshje.

Jeni të lutur të konfirmoni pëlqimin e Përfituesit për sa më sipër, duke caktuar një nëpunës të autorizuar të Përfituesit të nënshkruajë dhe të vendosë datën në kopjen bashkëlidhur të kësaj marrëveshjeje dhe t'ia kthejë Bankës Botërore. Pas marrjes nga Banka Botërore të kësaj kopjeje të sigluar, kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e siglimit.

Me konsideratën më të lartë,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga Ellen A. Goldstein
Drejtore vendi për Evropën Juglindore
Evropën dhe Azinë Qendrore
Rënë dakord:
Shqipëria
Nga_____
Përfaqësues i autorizuar
Emri: _____
Titulli: _____
Datë: _____

Bashkëlidhur:

1. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 15 shkurt 2012.

2. Letër disbursimi e së njëjtës datë si e kësaj marrëveshjeje, së bashku me udhëzimet e Bankës Botërore për disbursimet për projektet, të datës 1 maj 2006.

Granti nr. TF014761

ANEKSI

Neni I

Kushtet standarde; përkufizime

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e dhëna nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 15 shkurt 2012 (kushte standarde) përbëjnë një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.02 Përkufizime. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë marrëveshje kanë kuptimet e dhëna atyre në kushtet standarde ose në këtë marrëveshje, dhe termat shtesë të mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme.

a) "Kosto operative shtuese" nënkupton shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme që shkaktohen nga ARA për zbatimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e grantit, duke përfshirë udhëtimet lokale, pajisjet e zyrës, kostot e komunikimit, komisionet e arsyeshme bankare, përkthimet, shërbimet noteriale dhe duke përfshirë koston për dhënien e licencave për sistemin e menaxhimit financiar për të reflektuar në mënyrë të përshtatshme operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me grantin dhe zëra të tjerë të shpenzimeve që janë rënë dakord nga Banka Botërore gjatë të gjithë kohëzgjatjes së grantit (por duke

përjashtuar shërbimet e konsulentëve dhe pagat e punonjësve të shërbimit civil të Përfituesit).

b) "Trajnim" nënkupton kurset, seminaret, mbledhjet e punës dhe aktivitete të tjera trajnimi në lidhje me grantin, që nuk përfshihen sipas kontratave të ofruesit të shërbimeve, duke përfshirë kostot e materialeve të trajnimit, qiranë e mjediseve dhe pajisjeve, udhëtimet, akomodimin dhe dietat e personave që trajnohen dhe trajnerëve, tarifat e trajnerëve dhe kosto të tjera të ndryshme në lidhje me trajnimin që janë miratuar nga Banka Botërore.

c) "Ekipi i zbatimit" nënkupton departamentin ARA me detyrë zbatimin e grantit, në formë dhe me funksione, personel, burime, terma reference dhe kualifikime të pranueshme për Bankën Botërore, duke përfshirë specialistët e prokurimit dhe menaxhimit financiar.

Neni II
Zbatimi i grantit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i grantit

Objektivi i zhvillimit të grantit është mbështetja e qeverisë së Shqipërisë në përgatitjen e projektit të sigurisë dhe mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në rezultate (RRMSP) dhe rritja e kapacitetit të Autoritetit Shqiptar të Rrugëve në menaxhimin e aseteve rrugore dhe sigurisë rrugore. Përgatitja e duhur e RRMSP-së do të kontribuojë në një përdorim më të mirë dhe efektiv të financimit të kufizuar nga qeveria në përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve.

Granti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Komponenti 1 do të financojë fushën prioritare të riparimit/mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve kombëtare dhe përgatitjen e programit të vitit të parë të riparimit/mirëmbajtjes së RRMSP-së. Ky do të përfshijë, gjithashtu, rritjen e kapaciteteve në këto aktivitete (0.450 milion dollarë amerikanë):

a) Vlerësimi i inventarit të rrjetit ekzistues të rrugëve kombëtare dhe përmirësimi i përdorueshmërisë së sistemit ekzistues të menaxhimit të aseteve rrugore në ARA; identifikimi i mangësive që duhet të trajtohen gjatë projektit. Trajnimi gjatë punës i personelit të ARA-s për të pajisur me personel, mirëmbajtur dhe administruar sistemin e menaxhimit të aseteve rrugore të bazuar në kompjuter (RAMS);

b) Planifikimi dhe caktimi si prioritet i nevojave të riparimit/mirëmbajtjes së rrjetit të rrugëve kombëtare bazuar në kushtet faktike fizike (mundësia e përdorimit, funksionaliteti, siguria), kriteret social-ekonomike dhe shpërndarja e balancuar gjeografike; dhe përgatitja e dokumenteve të projektimit dhe ofertimit të vitit të parë të RRMSP-së (dokumentet e ofertimit do të përfshijnë rekomandimet e auditimit të pavarur për sigurinë rrugore). Pas pilotimit të suksesshëm të kontratave të mirëmbajtjes, të bazuar në performancë në Shqipëri, planifikimi dhe caktimi i prioritetit do të konsiderojnë një qëndrim të balancuar ndërmjet kontraktimit të mirëmbajtjes, të bazuar në performancë dhe kontraktimit të mirëmbajtjes tradicionale, të bazuara në kontribute/rezultate të tenderuara në mënyrë konkurruese. Ky komponent do të përfshijë mbështetjen e kapaciteteve për ARA-n në planifikimin dhe caktimin e prioritetit dhe në zgjerimin e kontraktimit të mirëmbajtjes, të bazuar në performancë.

Komponenti 2 do të financojë fuqizimin e Autoritetit Shqiptar të Rrugëve dhe Sekretariatin e Këshillit Ndërministror për Sigurinë e Rrugëve në sigurinë rrugore (0.055 milion dollarë amerikanë):

a) Prezantimi i praktikave të auditimit të sigurisë rrugore si pjesë e operacionalizimit të planeve të veprimit të sigurisë rrugore, duke përfshirë zhvillimin e auditimeve të pavarura për sigurinë rrugore për seksionet prioritare në fazën e projektimit dhe përfshirjen e standardeve të sigurisë rrugore në dokumentet ofertuese;

b) Fuqizimi i kapacitetit të sigurisë rrugore dhe trajnimi për Sekretariatin e Këshillit Ndërministror të Sigurisë Rrugore në fushën e bashkërendimit ndërministror, shtrirjen te publiku dhe monitorimin e zbatimit të planit të veprimit.

Komponenti 3 do të financojë aktivitetet e kujdesit të duhur mjedisor dhe social (0.100 milion US$):

a) Përgatitja e dokumenteve të garancive mjedisore dhe sociale, duke përfshirë Kuadrin e

Menaxhimit Mjedisor (EMF), Planet e Menaxhimit Mjedisor (AMP) për programin e riparimit/mirëmbajtjes në vitin e parë të RRMSP-së, Kuadrin e Politikës së Rivendosjes (RPF), planet e veprimit të rivendosjes për programin e riparimit/mirëmbajtjes në vitin e parë të RRMSP-së (sipas rastit);

b) Rishikimi dhe identifikimi i boshllëqeve/mospërputhjeve ndërmjet rregulloreve që rregullojnë politikat e garancive mjedisore dhe sociale të qeverisë dhe udhëzimeve të Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian; ofrimi i trajnimit gjatë punës për personelin e ARA-s për të përgatitur dhe zbatuar dokumentet e garancisë mjedisore dhe sociale.

Komponenti 4 do të financojë aktivitetet e mbështetjes së zbatimit (0.095 milion US$):

a) Përkufizimi i RRMSP PDO dhe DLI-ve në lidhje me zbatimin e riparimit/mirëmbajtjes së rrugëve dhe vendosja e vlerave dhe objektivave vjetorë bazë;

b) Përgatitja e manualit të operimit të projektit RRMSP;

c) Mbështetja e menaxhimit dhe e zbatimit të grantit për ARA-n, duke përfshirë auditimin dhe trajnimin.

2.02 Zbatimi i grantit në përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij për objektivat e projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi e zbaton grantin nëpërmjet ARA-s së tij, në pajtim me dispozitat e: a) nenit II të kushteve standarde; b) "Udhëzimeve për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s" të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 (udhëzimet antikorrupsion); dhe c) këtij neni II.

2.03 Masat institucionale dhe masa të tjera

a) Përfituesi ngarkon ARA-n të zbatojë grantin nëpërmjet ekipit të tij të zbatimit, e cila është përgjegjëse për përgatitjen e RRMSP-së dhe zbatimin e përgjithshëm të grantit.

b) Përfituesi ngarkon ARA-n të mirëmbajë, gjatë kohëzgjatjes së grantit, ekipin e zbatimit, në formë dhe me funksione, personel, burime, terma reference dhe kualifikime të pranueshme për Bankën Botërore, duke përfshirë specialistët e prokurimit dhe menaxhimin financiar.

c) Përfituesi i ngarkon përgjegjësinë e përgjithshme të grantit zëvendësdrejtorit të ARA-s që vepron si menaxher, i cili siguron, gjithashtu, lidhjen strategjike ndërmjet përgatitjes së RRMSP-së dhe dhënies së efektshme të grantit.

2.04 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i grantit

a) Përfituesi monitoron dhe vlerëson progresin e grantit dhe përgatit raporte progresi në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde dhe mbi bazën e treguesve të përcaktuar në paragrafin (b) të këtij seksioni (treguesit e nivelit GDO, si dhe treguesit e rezultateve të ndërmjetme të përcaktuara në aneksin 1 të dokumentit të projektit). Çdo raport granti mbulon periudhën e një semestri kalendarik dhe i paraqitet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

b) Treguesit e performancës të përmendur më sipër në paragrafin (a) përbëhen nga treguesit e mëposhtëm të nivelit GDO:

Treguesi 1. Caktimin si prioritet të punëve të riparimit/mirëmbajtjes të rrjetit të rrugëve kombëtare; dhe përgatitjen e programit të vitit të parë të riparimit/mirëmbajtjes të RRMSP-së.

Treguesi 2. Prezantimi i praktikave të auditimit të sigurisë rrugore në projektin e punëve të rrugëve.

Treguesi 3. Përkufizimi i objektivave të zhvillimit të RRMSP-së dhe treguesve të lidhur me disbursimin (DLI), duke përshirë mirëmbajtjen, sigurinë rrugore, reformat institucionale dhe vendosjen e vlerave të synuara dhe bazës fillestare referuese përkatëse.

c) Përfituesi përgatit raportin e përfundimit në pajtim me dispozitat e seksionit 2.06 të kushteve standarde. Raporti i përfundimit i paraqitet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.06 Menaxhimi financiar

a) Përfituesi garanton mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Përfituesi garanton përgatitjen e raporteve financiare të brendshme të paaudituara të projektit dhe paraqitjen pranë Bankës Botërore jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik që mbulon semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën Botërore.

c) Përfituesi auditon pasqyrat e tij financiare në pajtim me dispozitat e seksionit 2.07(b) të kushteve standarde. Çdo auditim i tillë i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Përfituesit. Pasqyrat financiare të audituara për çdo periudhë të tillë duhet t'i paraqiten Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.07 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat, shërbimet e jokonsulentëve dhe shërbimet e konsulentëve që kërkohen për grantin dhe që duhet të financohen, plotësisht ose pjesërisht, nga shumat e grantit prokurohen në pajtim me kërkesat e përcaktuara dhe të përmendura në:

i) seksionin I të "Udhëzimeve: Prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimet jokonsulente sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 (udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave dhe shërbimeve të jokonsulencës;

ii) seksionet I dhe IV të "Udhëzimeve: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga huamarrësit e Bankës Botërore", të muajit janar 2011 (udhëzimet për konsulentët) në rastin e shërbimeve të konsulentëve; dhe

iii) dispozitat e këtij seksioni, ku e gjitha shtjellohet në planin e prokurimit të përgatitur dhe të përditësuar të paktën çdo vit nga përfituesi i grantit në pajtim me paragrafin 1.18 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.25 të udhëzimeve të konsulentit (plani i prokurimit).

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorur në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e rishikimit nga Banka Botërore të kontratave të veçanta, i referohen metodës së përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve të konsulentit, sipas rastit.

c) Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave dhe shërbimeve të jokonsulentëve. Mallrat dhe shërbimet e jokonsulentëve prokurohen sipas kontratave të dhëna mbi bazën e blerjes.

d) Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Metodat e mëposhtme mund të përdoren për prokurimin e shkërbimeve të konsulentëve për ato detyra që specifikohen në planin e prokurimit: A) Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe kosto; B) Përzgjedhja me koston më të ulët; C) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks; D) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; B) Përzgjedhja e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore të vendimeve të prokurimit. Plani i prokurimit përcakton ato kontrata që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit pasues të Bankës Botërore.

Neni III
Tërheqja e shumave të grantit

3.01 Shpenzime të pranueshme. Përfituesi mund të tërheqë shumat e grantit në pajtim me dispozitat e: a) kushteve standarde; b) këtij seksioni; dhe c) atyre udhëzimeve shtesë që Banka Botërore mund të përcaktojë nëpërmjet njoftimit drejtuar Përfituesit (duke përfshirë "Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet", të muajit maj 2006, të rishikuar herë pas here nga Banka Botërore dhe që bëhet e zbatueshme për këtë marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për të financuar shpenzimet e pranueshme të parashikuara në tabelën e mëposhtme, tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të pranueshme, që mund të financohen nga shumat e grantit (kategoria), alokimet e shumave të grantit për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që financohen për shpenzimet e pranueshme në çdo kategori:

Kategoria	**Shuma e grantit të alokuar (shprehur në dollarë amerikanë)**	**Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen (duke përfshirë tatimet)**
1. Shërbimet e konsulentëve, mallrat, shërbime të jokonsulentëve, trajnimi,	700,000	100%

kostoja operacionale shtuese, auditimet		
TOTALI		

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk bëhet për pagesat e bëra para datës së siglimit të kësaj marrëveshjeje nga Përfituesi.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes, e përmendur në seksionin 3.06 (c) të kushteve standarde, është 31 dhjetori 2014.

Neni IV

Përfaqësuesi i Përfituesit; adresat

4.01 Adresa e përfaqësuesit. Përfaqësuesi i Përfituesit, i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde, është ministri i Financave.

4.02 Adresa e Përfituesit. Adresa e Përfituesit, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Faks:
+355 4 222 8494

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore, e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde, është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Kabllo:	Teleks:	Faks:
INTBAFRAD/ INDEVAS Washington, D.C.	248423 (MCI) ose 64145 (MCI)	1-202-477-6391